

Kombetarja / Stervitje me dy seanca!

nga AlbaniaSoccer
E martë, 02 Mars 2010 00:53



Ne ditën e tretë të grumbullimit të ekipit kombëtar në prag të sfidës me përfaqësuesen e Irlandës së Veriut sipas programit sot u zhvilluan dy stervitje në orën 10.30 dhe në orën 16.15.

Në stervitjen e parë grupi ishte perseri i reduktuar, ku u bashkuan Duro, Skela, Kapllani, Hyka, Hidi me grupin e lojtareve.

Mbasdite me ekipin u bashkuan dhe Lala, Bogdani, Beqaj, Salihi. Mungonin vetëm Cana, Curri dhe Dallku të cilët kanë mbërritur sot në mbremje.

Në stervitjen e mbasdites trajneri Josip Kuzhe i ndau lojtaret në dy grupe ku u luajt 4 kundra 4 dhe më pas 6 kundra 6.

Nëse ekipi kombëtar do të zhvillojë stervitjen e fundit në orën 16:15.

Media FSHF